



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	21. 07. 2023	3 viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shiur. Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHANKICK	5324/2023		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.835/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.835/2023 të datës 12.06.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike-administrative "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 21.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **Shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.835/2023 të datës 12.06.2023, të parashtruar nga ankuesi

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 12.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.2/951 të datës 11.05.2023 të Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Shkeljes esenciale të dispozitave ligjore të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës dhe konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme vetëm Këshilli)

në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa kjo e fundit më datë 20.06.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 02.06.2023 me Nr.protokolli 4703/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 2/070 të datës 17.01.2023 nga Sekretarja e Përgjithshme e MASHT-it; Vendimin me numër 2/951 të datës 11.05.2023 nga Sekretarja e Përgjithshme e MASHT-it; Komunikimin elektronik të datës 17.05.2023 ndërmjet ankuesit dhe Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore të MASHT-it; Vendimin me numër 2-355 të datës 28.02.2020 nga Ushtruesi i detyrës së Sekretares së Përgjithshme të MASHT-it; Akt emërimit me numër 4/4-8 të datës 02.08.2018; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.06.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 20.06.2023 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Kontratën e ankuesit me numër 415-ref 5/2-1-300 të datës 01.07.2000; Vendimin me numër 344/2 të datës 01.09.2009 nga Ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT-it; Kontratën e ankuesit me numër 415-ref-1-323 të datës 01.09.2009; Shkresën zyrtare me Nr.Prot.048 të datës 10.05.2011 nga MASHT-i; Vendimin me Nr.2-183 të datës 01-02-2016 nga Ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT-it; Kontratën e punës së ankuesit me numër 415-ref:2-45 të datës 22.06.2011; Akt emërimit e ankuesit të datës 11.05.2012; Akt emërimit e ankuesit me numër 4/4-8 të datës 02.08.2018; Kërkesën për ngritjen e koeficientit të datës 01.08.2018 sipas shkresës me numër 5/2-1725 nga Drejtori i departamentit të financave dhe shërbimeve të përgjithshme të MASHT-it; Shkresën zyrtare me numër 3457 të datës 23.11.2017 nga Udhëheqësi i divizionit të buxhetit dhe financave në MASHT; Vendimin me numër 2-1725 të datës 02.08.2018 nga Sekretari i Përgjithshëm i MASHT-it; Përshkrimin e detyrave të punës; Vendimin me numër 2-355 të datës 28.02.2020 nga Ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT-it; Akt emërimit e ankuesit 4/4-1 të datës 28.02.2020; Vendimin për pensionim me numër Ref: 2/069 të datës 17-01-2023 nga Sekretarja e Përgjithshme e MASHT-it; Kartelën e nëpunësit civil të datës 16.06.2023 për periudhën mars-maj 2023; Komunikimet elektronike të datës 19.06.2023 dhe 17.05.2023 ndërmjet ankuesit dhe zyrtarëve brenda institucionit në MASHT.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi ka ushtruar pozitën e punës si *Zyrtar për transport (vozitës)* në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke ju referuar nenit 2 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se zyrtarët publikë ndahen në: *nëpunës të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); nëpunësi i Shërbimit Publik; nëpunësi i Kabinetit; dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës* si dhe bazuar në paragrafin 6 të të njëjtit nen ku theksohet se: *“Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e*



administratës publike”, konstatoi se pozita “Zyrtar për transport (vozitës)” hyn në kategorinë e nëpunësve të shërbimit administrativ dhe mbështetës, rrjedhimisht pozita në fjalë nuk është pozitë e shërbimit civil. Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.835/2023 të datës 12.06.2023 të parashtruar nga ankuesi


Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji duke u bazuar në nenin 24 paragrafin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, konstaton se nëpunësit *administrativo-teknik dhe mbështetës* fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.835/2023.

Ardita Perçuku-SHYTI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

